



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.619/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkritazi me ankesën e parashtruar nga Valentina Alijaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Gjakovë, nga subjekti politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa parashtruar nga Valentina Alijaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Gjakovë, nga subjekti politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, me shenjën ZL.Anr.619/2017 e datës 09.11.2017, të parashtruar kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtare nga KQZ më datë 08.11.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.11.2017, nga Valentina Alijaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Gjakovë, nga subjekti politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, me të cilën pretendon se në Qendrën e Votimit nr. 0219C, gjatë numërimit dhe klasifikimit të votave është bërë shkelje e votave duke mos figuruar në FRK të cilat janë bartur nga FLIKA.

Më tej ka theksuar se gjashtë vota të cilat gjenden në këtë Qendër të Votimit janë vota të vlefshme dhe reale. Po ashtu, ka theksuar se komisioneri Blerim Sefaj si dhe vet votuesit në atë Qendër kanë deklaruar se ato gjashtë vota janë të vlefshme.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesja e ankesës Valentina Alijaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Gjakovë, nga subjekti politik NISMA për Kosovën, në ankesën e

parashtruar nuk e ka specifikuar se në cilin vendvotim të Qendrës së Votimit 0219C i mungojnë 6 votat e pretenduara, ngase QV-ja e lartpërmendur posedon 3 vendvotime, ashtu si është përcaktuar në nenin 5.7 pika (b) dhe (c) të Rregullës dhe Procedurave të PZAP-së nr.02/2015, ku përcaktohet: *”Të gjitha ankesat duhet të kenë së paku këto informacione: një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën kohën dhe vendin e shkeljes së pretenduar; hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit”*.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.619/2017 më datën 10.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*